



Republika e Shqipërisë
Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë
Universiteti "Eqrem Çabej"
Gjirokastrë



Republika e Shqipërisë
Ministria e Financës dhe Ekonomisë
Shkolla e Mesme Profesionale "Thoma Papapano"
Gjirokastrë

Nr. 876 Prot.

Datë 25.06.2019

Nr. 115 Prot.

Datë 25.06.2019

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

E lidhur sot në datën 25.06.2019 ndërmjet palëve:

**Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastrë përfaqësuar nga
Rektori, Prof.Dr Bektash MEMA**

dhe

**Shkolla e Mesme Profesionale "Thoma Papapano" Gjirokastrë përfaqësuar nga
Drejtori, Zj. Renata Puleri**

Palët e mësipërme duke pasur si qëllim të përbashkët zhvillimin dhe promovimin e arsimit profesional dhe në kuadër të vazhdimësisë së shkollimit profesional, bien dakord për sa më poshtë:

Neni 1

Baza ligjore

Kjo marrëveshje mbështetet në: Ligjin Nr. 15/2017 "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë"; Ligjin Nr. 23/2018 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10247, datë 4.3.2010, "Për kornizën shqiptare të kualifikimeve"; Vendimin nr. 514, datë 20.9.2017 "Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP), të rishikuar"; Strategjinë e punësimit dhe aftësive, 2014-2020, e Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Tiranë 2014; Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020, miratuar nga Këshilli i Ministrave (maj 2016); dhe Ligjin Nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë".

Neni 2

Qëllimi i marrëveshjes

Kjo marrëveshje ka për qëllim fillimin e bashkëpunimit midis dy institucioneve tona në drejtim të forcimit, zhvillimit dhe përdorimit të ndërsjelltë të kapaciteteve infrastrukturore, shkencore dhe njerëzore për të përballuar zhvillimin me sukses të studimeve në programin me karakter profesional, prej 120 ECTS, me kohëzgjatje 2 vjeçare, për TEKNIK ELEKTRIK.



Neni 3

Objekti i marrëveshjes

Kjo marrëveshje ka për objekt fillimin e bashkëpunimit midis dy institucioneve tona lidhur me:

- përdorimin e ndërsjelltë të kapaciteteve infrastrukturore në lidhje me praktikat vëzhguese dhe profesionale të parashikuara në planin mësimor të këtij programi studimi.
- përdorimin e ndërsjelltë të kapaciteteve shkencore dhe njerëzore të personelit akademik/mësimor për realizimin e procesit mësimor të parashikuar në planin mësimor.

Neni 4

Angazhimi i Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë

Universiteti "Eqrem Çabej" merr përsipër hartimin e planit mësimor dhe programeve lëndore, realizimin e tyre, bazuar në standardet e profesioneve përkatëse dhe standardet e kualifikimeve profesionale, mbështetur në rezultatet e të nxënit të cilat janë në vijimësi të arsimimit profesional në përputhje me Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve. Merr përsipër gjithashtu zhvillimin e seminareve ose konferencave të përbashkëta me fokus arsimin profesional.

Neni 5

Angazhimi i Shkollës së Mesme Profesionale "Th. Papapapano" Gjirokastrë

Përdorimin e kapaciteteve infrastrukturore në lidhje me praktikat vëzhguese dhe profesionale të parashikuara në planin mësimor të këtij programi studimi. Përdorimin e kapaciteteve shkencore dhe njerëzore të personelit akademik/mësimor për realizimin e procesit mësimor të parashikuar në planin mësimor. Siguron gjithashtu azhurnimin rreth çështjeve të kurrikulës dhe të trajnimit në arsimin parauniversitar, për të reflektuar më mirë ndaj objektivave të zhvillimit të arsimit shqiptar dhe për të mbështetur politikat arsimore dhe reformat në të gjitha nivelet e arsimit.

Neni 6

Zbatimi i marrëveshjes

Pas nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje dhe hyrjen në fuqi të saj, utorizohen drejtuesit ose koordinatorë të autorizuar prej tyre për zbatimin në praktikë rast pas rasti të angazhimeve të ndërsjella.

Neni 7

Afati i marrëveshjes

Kjo marrëveshje bashkëpunimi është pa afat, me dëshirën e përbashkët që të jetë afatgjatë, megjithatë secila palë mund të tërheqet në çdo kohë duke njoftuar me shkrim palën tjetër të paktën një muaj më parë.

Neni 8

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Mosmarrëveshjet në lidhje me zbatimin e angazhimeve të ndërsjella zgjidhen me mirëkuptim reciprok.




Neni 9

Marrëdhëniet financiare të personelit akademik të përfshirë në këtë program studimi rregullohen me aktet ligjore në fuqi.

Kjo marrëveshje është e detyrueshme nga palët nënshkruese për realizimin e saj.

Kjo marrëveshje hartohet në dy kopje të njëta, nga një për secilën palë.

Prof. Dr. Bektash Mema



Renata Puleri





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERISTETI "EQREM ÇABEJ"

FAKULTETI I EDUKIMIT DHE SHKENCAVE SHOQËRORE

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

MIDIS

FAKULTETIT TË EDUKIMIT DHE SHKENCAVE SHOQËRORE DHE FAKULTETIT TË SHKENCAVE TË NATYRËS

Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqërore i përfaqësuar nga **Dekani, Prof.dr. Gëzim Sala** (më poshtë **FESHSH**)

dhe

Fakulteti i Shkencave të Natyrës i përfaqësuar nga **Dekani, Prof.Asoc. Selfo Oruçi** (më poshtë **FSHN**),

Duke vlerësuar kontributin e deritanishëm në veprimtarinë akademike dhe zhvillimin e aktiviteteve të përbashkëta;

të angazhuar në rritjen dhe garantimin e cilësisë në arsimin e lartë;

me dëshirën për të kontribuar në zhvillimin ekonomik, social dhe kulturor në nivel rajonal dhe kombëtar;


për të siguruar formimin e specialistëve të lartë në përputhje me prioritetet e zhvillimit të vendit,

palët bien dakord të nënshkruajnë këtë **Marrëveshje Bashkëpunimi** (më poshtë **Marrëveshja**).

Neni 1 Baza ligjore

Kjo marrëveshje bashkëpunimi mbështetet në Ligjin Nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", aktet nënligjore të dalë në zbatim të tij, Statutin dhe Rregulloren e Brendshme të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë.

Neni 2



Qëllimi

Kjo marrëveshje ka për qëllim bashkëpunimin e ndërsjellë midis **FESHSH** dhe **FSHN** në:

- Zbatimin e standarteve më të larta gjatë kryerjes së veprimtarisë së mësimdhënies në programet e ofruara sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi;
- Programimin dhe organizimin me eficiencë të veprimtarisë së mësimdhënies;
- Zbatimin e procedurave më të mira në zbatim të ligjit për ofrimin e personelit akademik të nevojshëm për realizimin e procesit mësimor;
- Realizimin e aktiviteteve të përbashkëta kërkimore dhe shkencore në fusha me interes të përbashkët.

Neni 3

Të drejtat dhe detyrimet e palëve

Në përmbushje të kësaj marrëveshje, **FESHSH** dhe **FSHN** kanë këto të drejta dhe detyrime:


1. Të garantojnë lirinë akademike dhe cdo të drejtë tjetër që buron nga ligji i arsimit të lartë, Kodi i Punës si dhe cdo akt tjetër ligjor e nënligjor në fuqi;
2. Të shfrytëzojnë të gjitha mundësitë që ofron institucioni, duke respektuar të gjitha rregullat e vendosura;
3. Të përmbushin të gjitha detyrimet e marra përsipër gjatë realizimit të veprimtarisë së mësimdhënies;
4. Të ofrojnë njohuri dhe dije shkencore në përputhje me objektivat e përgjithshëm dhe specifike të programeve të studimit në të cilat ata janë të angazhuar;
5. Të përditësojnë dokumentacionin shkollor, programet lëndore dhe literaturën në përputhje me arritjet më të mira shkencore;
6. Të realizojnë veprimtarinë mësimdhënëse me format më bashkëkohore në funksion të studentëve;
7. Të shkëmbejnë eksperiencë të dyanshme në zhvillimin e metodave dhe kurrikulave mësimore;
8. Të japin ndihmë të përbashkët në rritjen e kualifikimeve shkencore të stafit akademik;
9. Të organizojnë simpoziume apo konferenca, programe dhe projekte të përbashkëta kërkimore, me interes të dyanshëm;
10. Të respektojnë Kodin e Etikës dhe cdo detyrim që rrjedh nga Kodi i Punës dhe ligji i arsimit të lartë.

Neni 4

Ndryshime

FESHSH dhe **FSHN** do të respektojnë parimin e mirëbesimit të ndërsjellë. Palët mund të bëjnë ndryshime, përmirësime apo/dhe shtesa në këtë Marrëveshje me pëlqimin e ndërsjellë të tyre. Çdo ndryshim, përmirësim apo/dhe shtesë do të bëhet nga drejtuesit e **FESHSH** dhe **FSHN** dhe do të hyjë në fuqi pas nënshkrimit nga ana e tyre.

Neni 5



Afati i marrëveshjes

Kjo marrëveshje do të lidhet për një kohëzgjatje të pacaktuar. Marrëveshja mund të përfundojë nga secila Palë nëpërmjet dërgimit të një njoftimi me shkrim drejtuar Palës tjetër, të paktën një muaj përpara, duke iu përmbajtur të gjitha detyrimeve që rrjedhin prej saj.

Neni 6

Nënshkrimi dhe hyrja në fuqi

Kjo marrëveshje hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të saj.

Kjo marrëveshje është hartuar në katër kopje origjinale në gjuhën shqipe, nga dy për secilën prej palëve.

Gjirokastrë, 08.05.2018

Gjirokastrë, 08.05.2018

PËR
FAKULTETIN E EDUKIMIT DHE
SHKENCAVE SHOQËRORE



PËR
FAKULTETIN E SHKENCAVE TË NATYRËS

DEKANI

DEKANI

Prof.dr. Gëzim Sala

Prof.Asoc. Selfo Oruçi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
FAKULTETI I SHKENCAVE TË NATYRËS

Nr. 845 Prot.

Gjirokastrë, më 18.06.2019

MARREVESHJE BASHKEPUNIMI

E lidhur sot, më datën 18.06.2019 ndërmjet palëve:

Universiteti "Eqrem Cabej" Gjirokastrë përfaqësuar nga Rektori, Prof.Dr Bektash MEMA dhe Dekani i Fakultetit të Shkencave të Natyrës, Prof.Asoc.Dr Selfo ORUÇI.

dhe

Drejtoria Rajonale e Mjedisit Gjirokastrë, përfaqësuar nga Titullari, z. Jani Vasili në varësi të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit.

Palët me vullnet të lirë bien dakort për sa më poshtë vijon:

Neni 1


Baza ligjore

Kjo marrëveshje mbështetet në Ligjin Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kerkimin Shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Ligjin Nr.10 440, datë 7.7. 2011 "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis" Ligjin Nr. 10431, datë 09.06.2011; Neni 11 pika 3 dhe Neni 14 pika b. neni 57, neni 58 "Për Mbrojtjen e Mjedisit",

Neni 2

Qëllimi i marrëveshjes

Bashkëpunimi dhe veprimet e përbashkëta ndërmjet autoriteteve publike Rregullimi i bashkëpunimit akademiko-shkencor dhe profesional midis palëve nënshkruese me qëllim arritjen e objektivave për mbrojtjen e integruar të mjedisit.



Neni 3

Kohëzgjatja e marreveshjes

Kjo kontratë lidhet sot më datë 11.06.2018 dhe shtrin efektin e saj për njëperiudhe 3 (tre) vjeçare.

Neni 4

Detyrimet e palëve

Njësia Bazë e Biologji-Kimisë është strukturë akademiko-shkencore e Fakultetit të Shkencave të Natyrës në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastrë. Studentët e kësaj njësie do të kryejnë praktikën profesionale dhe aktivitetin kërkimor-shkencor pranë Drejtorise Rajonale të Mjedisit Gjirokastrë, e cili vë në dispozicion të Njesise Bazë të Biologji-Kimisë, ambjentet zyrtare dhe ato mjedisore të punës së vet.

Neni 5

Njësia Baze e Biologji - kimise në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, Universiteti "Eqrem Çabej" mundeson realizimin e praktikave profesionale të studenteve të saj në specialitetin në fjalë, në bashkëpunim me strukturat e drejtorise në fjalë.

Neni 6


Njësia Bazë e Biologji-Kimisë shërben si burim i njohurive më të fundit në fushën e menaxhimit dhe të mbrojtjes së mjedisit, nëpërmjet personelit akademik dhe shkencor të saj në bashkëpunim me specialistet e Drejtorise rajonale të Mjedisit Gjirokastrë.

Neni 7

Njësia Bazë e Biologji-Kimisë në bashkëpunim me specialistet e Drejtorise rajonale të Mjedisit Gjirokastrë ofrojnë gjithë asistencën e duhur ligjore e praktike në ndihmë të studenteve.

Neni 8

Njësia Bazë e Biologji-Kimisë e Fakultetit të Shkencave të Natyrës në bashkëpunim me specialistet e Drejtorise rajonale të Mjedisit Gjirokastrë, do të mundësojë bashkëpunimin



mësimor, kërkimor-shkencor dhe realizimin e pjesëmarrjen e tyre ne Konferenca Shkencore Kombëtare dhe Ndërkombëtare.

Neni 9

Duke shfrytëzuar bashkepunimet që ka Universiteti "Eqrem Çabej" me homologet e vet europianë, Njesia Baze e Biologji-Kimisë, si pjesë e këtij Universiteti, do te mundesoj nxitjen e kualifikimeve afatshkurtra dhe afatgjata ne fushen e menaxhimit dhe mbrojtjes se mjedisit.

Neni 10

Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, Fakulteti i Shkencave të Natyrës dhe Njësia Baze e Biologji-Kimisë angazhohen për rritjen e shkallës së profesionalizmit nëpërmjet sensibilizimit mbi problemet e ndotjes dhe monitorimit te vazhdueshem te mjedisit.

Neni 11

Marrëdhëniet financiare të personelit akademik dhe atij ndihmës mësimor të Njesisë Bazë të Biologji-Kimisë mbulohen nga Universiteti "Eqrem Çabej" dhe rregullohen me aktet ligjore në fuqi

Kjo marreveshje është e detyrueshme nga palët nënshkruese për realizimin e saj.


Drejtoria Rajonale e Mjedisit

Drejtori. Jani Vasili



Dekani i FSHN

Prof.asoc. Selfo Oruçi



Prof. Dr. Bektash Mema



UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
FAKULTETI I SHKENCAVE TË NATYRËS

Nr. 846.. Prot.

Gjirokastër, më 19/06/2019

MARREVESHJE BASHKWPUNIMI

E lidhur sot, në datën 19/06/2019 ndërmjet palëve:

Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokaster përfaqesuar nga Rektori, Prof.Dr Bektash MEMA dhe Dekani i Fakultetit të Shkencave të Natyrës, Prof.Asoc.Dr Selfo ORUÇI.

dhe

Administrata e Zonave të Mbrojtura pranë Drejtorisë së Bujqësisë, Gjirokastër përfaqesuar nga Drejtori, z. Gligor Dushi

Palët me vullnet të lirë bien dakort për sa më poshtë vijon:

Neni 1

Baza ligjore

Kjo marrëveshje mbështetet në Ligjin Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kerkimin Shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Ligjin Nr.10 440, datë 7.7. 2011 "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis" Ligjin Nr. 10431, datë 09.06.2011; Neni 11 pika 3 dhe Neni 14 pika b, neni 57, neni 58 "Për Mbrojtjen e Mjedisit",

Neni 2

Qëllimi i marreveshjes

Rregullimi i bashkëpunimit akademiko-shkencor dhe profesional midis palëve nënshkruese.

Neni 3

Kohëzgjatja e marreveshjes



Kjo kontratë lidhet sot më datë 19.06.19 dhe shtrin efektin e saj për një periudhë 3 (tre) vjeçare.

Neni 4

Detyrimet e palëve

Njësia Bazë e Biologji-Kimisë është strukturë akademiko-shkencore e Fakultetit të Shkencave të Natyrës në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastrë. Studentët e kësaj njësie do të kryejnë praktikën profesionale dhe aktivitetin kërkimor-shkencor pranë Administratës Rajonale e Zonave të Mbrojtura Gjirokastrë, e cili vë në dispozicion të Njesisë Bazë të Biologji-Kimisë, ambjentet zyrtare dhe ato mjedisore të punës së vet.

Neni 5

Njësia Baze e Biologji - kimise në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, Universiteti "Eqrem Çabej" mundëson realizimin e praktikave profesionale të studenteve të saj në specialitetin në fjalë, në bashkëpunim me strukturat e drejtorisë në fjalë.

Neni 6

Njësia Bazë e Biologji-Kimisë shërben si burim i njohurive më të fundit në fushën e menaxhimit dhe të mbrojtjes së mjedisit, nëpërmjet personelit akademik dhe shkencor të saj në bashkëpunim me specialistet e Administratës Rajonale e Zonave të Mbrojtura Gjirokastrë

Neni 7

Njësia Bazë e Biologji-Kimisë në bashkëpunim me specialistet e Administratës Rajonale e Zonave të Mbrojtura Gjirokastrë ofrojnë gjithë asistencën e duhur ligjore e praktike në ndihmë të studenteve.

Neni 8

Njësia Bazë e Biologji-Kimisë e Fakultetit të Shkencave të Natyrës në bashkëpunim me specialistet e Administratës Rajonale e Zonave të Mbrojtura Gjirokastrë, do të mundësojë bashkëpunimin mësimor, kërkimor-shkencor dhe realizimin e pjesëmarrjes së tyre në Konferencën Shkencore Kombëtare dhe Ndërkombëtare.

Neni 9

Duke shfrytëzuar bashkëpunimet që ka Universiteti "Eqrem Çabej" me homologët e vet evropianë, Njësia Baze e Biologji-Kimisë, si pjesë e këtij Universiteti, do të mundësojë nxitjen e kualifikimeve afatshkurtra dhe afatgjata në fushën e menaxhimit dhe mbrojtjes së mjedisit.

Neni 10

Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, Fakulteti i Shkencave të Natyrës dhe Njësia Baze e Biologji-Kimisë angazhohen për rritjen e shkallës së profesionalizmit nëpërmjet sensibilizimit mbi problemet e ndotjes dhe monitorimit të vazhdueshëm të mjedisit.

Neni 11




Marrëdhëniet financiare të personelit akademik dhe atij ndihmës mësimor të Njesisë Bazë të Biologji-Kimisë rregullohen me aktet ligjore në fuqi

Kjo marreveshje është e detyrueshme nga palët nënshkruese për realizimin e saj.



Administrata Rajonale e Zonave të Mbrojtura

Dr. Gligor Gushi



Dekani i FSHN

Prof.asoc. Selfo Oruçi





Republika e Shqipërisë
Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë
Universiteti "Eqrem Çabej"
Gjirokastrë



Republika e Shqipërisë
Ministria e Financës dhe Ekonomisë
Shkolla e Mesme Profesionale "Thoma Papapano"
Gjirokastrë

Nr. 876 Prot.

Datë 25.06.2019

Nr. 115 Prot.

Datë 25.06.2019

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

E lidhur sot në datën 25.06.2019 ndërmjet palëve:

Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastrë përfaqësuar nga
Rektori, Prof. Dr. Bektash MEMA

dhe

Shkolla e Mesme Profesionale "Thoma Papapano" Gjirokastrë përfaqësuar nga
Drejtori, Zj. Renata Puleri

Palët e mësipërme duke pasur si qëllim të përbashkët zhvillimin dhe promovimin e arsimit profesional dhe në kuadër të vazhdimësisë së shkollimit profesional, bien dakord për sa më poshtë:

Neni 1

Baza ligjore

Kjo marrëveshje mbështetet në: Ligjin Nr. 15/2017 "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë"; Ligjin Nr. 23/2018 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10247, datë 4.3.2010, "Për kornizën shqiptare të kualifikimeve"; Vendimin nr. 514, datë 20.9.2017 "Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP), të rishikuar"; Strategjinë e punësimit dhe aftësive, 2014-2020, e Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Tiranë 2014; Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020, miratuar nga Këshilli i Ministrave (maj 2016); dhe Ligjin Nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë".

Neni 2

Qëllimi i marrëveshjes

Kjo marrëveshje ka për qëllim fillimin e bashkëpunimit midis dy institucioneve tona në drejtim të forcimit, zhvillimit dhe përdorimit të ndërsjellë të kapaciteteve infrastrukturore, shkencore dhe njerëzore për të përballuar zhvillimin me sukses të studimeve në programin me karakter profesional, prej 120 ECTS, me kohëzgjatje 2 vjeçare, për TEKNIK ELEKTRIK.





REPUBLIKA E SHQIPËRISE
BASHKIA GJIROKASTËR



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
GJIROKASTËR

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

E lidhur sot, në datën 10 / 03 / 2017 ndërmjet palëve:

Bashkia Gjirokastrë (Bashkia) dhe **Universiteti "Eqrem Çabej" (Universiteti)**,
përfaqësuar nga Kryetari, përfaqësuar nga Rektori,
zj. Zamira RAMI. *Prof.dr Bektash MEMA.*

Palët e mësipërme duke patur si qëllim të përbashkët zhvillimin dhe promovimin e mëtejshëm të vlerave të qytetit të Gjirokastrës, sidomos të arsimit dhe kulturës gjirokastrite, e cila ka qënë gjithmonë në themel të kulturës kombëtare shqiptare dhe me bindjen se arsimi ka qënë dhe mbetet forca kryesore në përparimin e qytetit dhe vendit tonë, bien dakord për sa më poshtë:

Neni 1


Baza ligjore

Kjo marrëveshje merr shkas nga Ligji Nr. 139/2015 "Për vetqeverisjen vendore", Kreu VII dhe Kreu VIII por pa u kufizuar në to si dhe në Ligjin Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 48 pika 2 por pa u kufizuar në të.

Neni 2

Qëllimi i marrëveshjes

Kjo marrëveshje ka për qëllim fillimin e një bashkëpunimi të ngushtë midis dy institucioneve tona, në drejtim të forcimit, zhvillimit dhe përdorimit të ndërsjellë të kapaciteteve infrastrukturore, shkencore dhe njerëzore, për të përballuar sfidat e përbashkëta që kanë lindur me implementimin e reformës territoriale dhe asaj arsimore.



Neni 3

Angazhimi i universitetit

Universiteti "Eqrem Çabej" ofron në dobi të ushtrimit të funksioneve të Bashkisë Gjirokastër sa më poshtë:

Bashkëpunim në organizimin dhe vënien në dispozicion të sallave të veta për zhvillimin e konferencave, seminareve dhe të konsultimeve publike për çështje me interes të gjerë.

Ndihmë profesionale dhe shkencore në drejtim të hartimit dhe zbatimit të politikave vendore për zhvillimin dhe ruajtjen e arsimit, kulturës, turizmit, ekonomisë dhe trashëgimisë kulturore të Bashkisë Gjirokastër.

Vënien në dispozicion të studimeve kërkimore-shkencore dhe statistikore të realizuara nga njësitë bazë të universitetit për ato fusha që paraqesin interes për bashkinë.

Bashkëpunim në realizimin e publikimeve dhe botimeve në fusha me interes të përbashkët.

Mundësi konsultimi dhe studimi me fondin e librave në administrim të bibliotekës së universitetit për të gjithë banorët e bashkisë.

Pjesëmarrje e përbashkët në aplikimin për projekte të financuara nga Bashkimi European dhe financues të tjerë kombëtarë dhe ndërkombëtarë.

Neni 4

Angazhimi i bashkisë


Bashkia Gjirokastër ofron në dobi të veprimtarisë së Universitetit "Eqrem Çabej" sa më poshtë:

Vënien në dispozicion të mjediseve të stadiumit, pallatit të sportit, Teatrit "Zihni Sako" si dhe të mjediseve të tjera në administrim të bashkisë së qytetit, të cilat do të konsiderohen të nevojshme për realizimin e procesit mësimor dhe të aktiviteteve kulturore apo shkencore.

Mundësinë që studentët e universitetit të zhvillojnë praktika profesionale pranë bashkisë dhe në institucionet e tjera të varësisë sipas programeve të studimit.

Pjesëmarrje e përbashkët në aplikimin për projekte të financuara nga Bashkimi European dhe financues të tjerë kombëtarë dhe ndërkombëtarë.

Bashkëpunimin e bibliotekës së qytetit me bibliotekën e universitetit për të plotësuar nevojat e ndërsjellta për tituj librash si dhe konsultim të lirë të fondit të bibliotekës nga ana e studentëve.



Neni 5
Efektet financiare

Shërbimet e ndërsjellta të ofruara do të jenë pa pagesë.
Kostot administrative të ofrimit të shërbimeve të ndërsjellta përballohen nga institucionet përkatëse në përputhje me legjislacionin në fuqi.
Aplikimi i përbashkët në projekte të financuara nga donatorë të huaj apo vendas do të ketë të përcaktuar paraprakisht shkallën e pjesëmarrjes respektive.

Neni 6
Zbatimi i marrëveshjes

Me nënshkrimin dhe hyrjen në fuqi të kësaj marrëveshjeje sipas rregullave të secilit institucion, autorizohet Rectori i Universitetit dhe Kryetari i Bashkisë për zbatimin në praktikë rast pas rasti të angazhimeve të ndërsjellta, përmes korespondencës shkresore në formatin kërkesë-miratim.

Për raste të ngutshme lejohet edhe komunikimi elektronik në adresa zyrtare, por i dokumentuar më vonë shkresërisht.

Neni 7
Afati i marrëveshjes

Kjo marrëveshje bashkëpunimi është pa afat, me dëshirën e përbashkët që të jetë afatgjatë, megjithatë secila palë mund të tërhiqet në çdo kohë duke njoftuar me shkrim palën tjetër të paktën 1 muaj më parë.

Neni 8
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve


Mosmarrëveshjet në lidhje me zbatimin e angazhimeve të ndërsjellta zgjidhen me mirëkuptim reciprok të Rectorit të Universitetit dhe Kryetarit të Bashkisë.

Mosmarrëveshje në aspektin financiar nuk lejohen për sa kohë thelbi i ofrimit të ndërsjelltë të shërbimeve është pa pagesë.

Kjo marrëveshje hartohet në dy kopje të njëjta, nga një për secilën palë, lexohen dhe nënshkruhen pa vërshje.


Zamira RAMI
KRYETAR

Prof.dr. Bektash MEMA



REKTOR




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
GJIROKASTËR
FAKULTETI I EDUKIMIT DHE SHKENCAVE SHOQËRORE

ZYRA ARSIMORE RAJONALE
GJIROKASTER

DREJTORI
(Albana Hasani)



UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
GJIROKASTER

DEKANI
Prof. dr. Gezim Sala

G. Sala

e lidhur sot më 10. 10. 2019 midis Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë dhe Zyrës Arsimore Rajonale Gjirokastrë për caktimin e shkollave, dhe të mesuesve mentorë që do të mbikqyrin procesin e praktikës profesionale në programin e studimit të Ciklit parë: Mësuesi për Arsimin Fillor, Mësuesi për Arsimin Parashkollor dhe në programet e studimit të Ciklit të Dytë: "Master" në mësuesi për arsimin e mesëm të ulët në: Histori-geografi, gjuhë-letërsi, gjuhë angleze, gjuhë dhe qyteterim italian, gjuhë letërsi dhe qyteterim grek, biologji-kimi, matematikë - fizikë, matematikë - informatikë si dhe në programin "Master profesional" në mesues për arsimin fillor klasa I -V, "Master profesional" në mesues ndihmës në edukimin gjithpërfshirës

Palët bien dakort si me poshte:

1. Praktikat profesionale të studentëve të Universitetit të Gjirokastrës do të zhvillohen në mjediset e (shkollave) 9-vjeçare të qytetit me një shtrirje semestrale, sipas planeve dhe programeve të degëve përkatës.
2. Mësuesit mentorë që do të bashkëpunojnë për zhvillimin e praktikave profesionale vëzhguese, aktive duhet të jenë me përgatitje të lartë shkencore dhe metodike mundësisht me gradën magistër.
3. Zyra Arsimore Rajonale me fillimin e vitit të ri akademik, miraton propozimet e dërguara nga Universiteti, me emrat e mësuesve mentorë që plotësojnë kriteret shkencore metodike dhe i dërgon ato zyrtarisht pranë Universitetit të Gjirokastrës dhe Drejtorisë të shkollave.
4. Drejtoritë e shkollave që janë caktuar për këtë qëllim, janë të detyruara të krijojnë kushte e nevojshme për zhvillimin normal të praktikës profesionale, sipas programit të lëndës përkatëse.
5. Kjo akt-marrëveshje ka vlerë për zhvillimin e praktikave afatshkurtra (një ditë në javë) që zhvillojnë studentët, sipas strukturës së vitit akademik që hartojnë departamentet.
6. Lista emërore e mësuesve që propozojmë të jenë mentorë, sipas shkollave, është si më poshtë:



Nr	Departamenti	Shkolla ku do te zhvillohet praktika	Lënda	Emri, Mbiemri mësuesit
1	Histori-Gjeografi	9 - vjeçare "Koto Hoxhi"	Histori	Afrëdhiti Koça
			Gjeografi	Mirjeta Kufo
2	Gjuhë-Lëtersi	9 - vjeçare "Urani Rumbo"	Gjuhe	Kleomida Serjani
			Letërsi	
3	Gjuhë të Huaja	9 - vjeçare "Koto Hoxhi"	Anglisht	Manjola Ziu
4	Dep. i Edukimit dhe Metodologjisë së Mësimdhënies	9 - vjeçare "Koto Hoxhi"	Arsimi Fillor	Marjana Dhima Etleva Korkuti Mirela Mamani Eva Imeri Edlira Meçi Albana Muço Esmeralda Hitaj
		9 - vjeçare "Koto Hoxhi"	Arsimi Parashkollor	Luiza Hysi Natasha Vathi
		Cicërimat Kopështi nr.6		Faela Reçka (Kristo) Fatbardha Aliko
5	Gjuhë Greke	" Pandeli Sotiri "	Greqisht	Figalia Papa
6	Matematikë-Informatikë	9 - vjeçare "Koto Hoxhi"	Matematike	Violeta Çabej
			Informatikë	Zhuljeta Zhapa
7	Fizikë	9 - vjeçare "Koto Hoxhi"	Fizikë	Elvira Kazaqi
8	Biologji-Kimi	9 - vjeçare " Urani Rumbo "	Biologji	Merita Latë
		9 - vjeçare "Koto Hoxhi"	Kimi	Vezir Mamo

7. Në zbatim të pikës 3 të kësaj akt-marrëveshjeje, Zyra Arsimore Rajonale u detyron zyrtarisht Universitetit dhe Drejtorive të shkollave të miratuar apo me mundësi të mundshme, listën me emrat e shënuar në pikës 6.
8. Kjo akt-marrëveshje hyn në fuqi menjëherë.

Gjirokastër, më 10.10.2019



21.05.2020
Nr. 164 Prot
E.M.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
REKTORAT

Nr. 324.....prot

Gjirokastrë, më 06.03.2020

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

E lidhur sot, në datën 06.03.2020 ndërmjet palëve:

Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastrë përfaqësuar nga Rektori, Prof.dr Bektash MEMA dhe Dekani i Fakultetit të Shkencave të Natyrës, Prof. Asoc. Selfo ORUÇI.

dhe

Drejtorja e Spitalit Raional "Omer Nishani" Gjirokastrë, përfaqësuar nga Drejtori, z Sokol FERUNI

Palët me vullnet të lirë bien dakort për sa më poshtë vijon:

Neni 1

Baza ligjore

Kjo kontratë mbështetet në Ligjin Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", në Ligjin Nr. 9106, datë 17.07.2003 "Për Shërbimin Spitalor në Republikën e Shqipërisë" si dhe në Ligjin Nr. 10107, datë 30.03.2009 "Për Kujdesin Shëndetësor në Republikën e Shqipërisë".

Neni 2

Qëllimi i marrëveshjes

Rregullimi i bashkëpunimit akademiko-shkencor dhe profesional midis palëve nënshkruese.

Neni 3

Kohëzgjatja e marrëveshjes

Kjo kontratë lidhet sot më datë 06.03.2020 dhe shtrin efektin e saj për një periudhë 3 (tre) vjeçare.

Neni 4

Detyrimet e palëve

Njësia Bazë e Infermierisë është strukturë akademiko-shkencore e Fakultetit të Shkencave të Natyrës në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastrë. Studentët e kësaj njësie do të kryejnë praktikën profesionale dhe aktivitetin kërkimor-shkencor në Spitalin Rajonal Gjirokastrë. Spitali Rajonal Gjirokastrë është institucion publik i ofrimit të kujdesit shëndetësor të specializuar, i cili vë në dispozicion të Njesisë Bazë të Infermierisë, ambjentet klinike, laboratorët në të gjitha specialitetet strukturale, diagnostikuese, kurative në të gjitha repartet, si Shërbimin e Patologjisë, Shërbimin e Kirurgjisë, Shërbimin e Obstetrike-Gjinekologjisë, Shërbimin e Pediatrisë, Shërbimin e Urgjencës, Shërbimin Diagnostikues Imazhorik, Shërbimin e Ambulancës Qëndrore, Shërbimin e Sëmundjeve Infektive pa pagesë.

Neni 5



Neni 5

Njësia Bazë e Infermierisë në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, Universiteti "Eqrem Çabej" mundëson realizimin e praktikave profesionale të studentëve të saj në specialitete të ndryshme, në bashkëpunim me strukturat e kujdesit spitalor.

Neni 6

Njësia Bazë e Infermierisë shërben si burim i njohurive më të fundit në fushën e diagnostikimit dhe terapisë të sëmundjeve torakale, abdominale, vaskulare, endoskopisë digjestive, kirurgjikale, obstetrikale, pediatrike nëpërmjet personelit akademik dhe shkencor të saj në bashkëpunim me partnerë europiane dhe specialistët e Spitalit Rajonal Gjirokastrë

Neni 7

Njësia Bazë e Infermierisë në bashkëpunim me Spitalin Rajonal Gjirokastrë ofron për komunitetin diagnostikimin dhe terapiën intervenuese në fushën e sëmundjeve torako-abdominale, kirurgjikale dhe vaskulare.

Neni 8

Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, Fakulteti i Shkencave të Natyrës, Njësia Bazë e Infermierisë dhe Spitali Rajonal Gjirokastrë krijojnë mundësinë për punë kërkimore shkencore të pavarur të personelit dhe studentëve duke vënë në dispozicion kapacitete me teknologji të avancuara.

Neni 9

Njësia Bazë e Infermierisë e Fakultetit të Shkencave të Natyrës në bashkëpunim me Klinikat, Universitetet e huaja dhe Spitalin Rajonal Gjirokastrë, do të mundësojë bashkëpunimin mësimor, kërkimor-shkencor dhe realizimin e Konferencave Shkencore Kombëtare dhe Ndërkombëtare me pjesëmarrjen e specialistëve në fusha të ndryshme të mjekësisë.

Neni 10

Duke shfrytëzuar bashkëpunimet që ka Universiteti "Eqrem Çabej" me homologët e vet europianë, Njësia Bazë e Infermierisë, si pjesë e këtij Universiteti, realizon kualifikime afatshkurtra dhe afatgjata të pedagogëve, mjekëve, infermierëve, studentëve si dhe praktikantë profesionale.

Neni 11

Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, Spitali Rajonal Gjirokastrë, Fakulteti i Shkencave të Natyrës dhe Njësia Bazë e Infermierisë angazhohen për rritjen e shkallës së profesionalizimit nëpërmjet ngritjes së Sistemit të Edukimit Mjekësor të Vazhdueshëm dhe testimit për të gjitha kategoritë e personelit në mjekësi.

Neni 12


Marrëdhëniet financiare të personelit akademik mjek, infermier dhe ndihmës mësimor të Njësise Bazë të Infermierisë rregullohen me aktet ligjore në fuqi



Kjo marrëveshje është e detyrueshme nga palët nënshkruese për realizimin e saj.

Për Universitetin "Eqrem Çabej"
Prof.dr Bektash Mema

REKTOR



Fakulteti i Shkencave të Natyrës

Prof Asoc, Selfo Oruçi

DEKAN



Për spitalin Rajonal "Omer Nishani"

Sokol Feruni

DREKTOR





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DREJTORIA ARSIMORE RAJONALE
GJIROKASTËR


REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
GJIROKASTËR

DEKAN

PROF.DR GËZIM SALA



AKT - MARRËVESHJE



E lidhur sot më 20.10.2016 midis Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë dhe Drejtorisë Arsimore Rajonale Gjirokastrë për caktimin e shkollave dhe të mësuesve mentorë, që do të mbykqyrin procesin e praktikës profesionale në programin e Ciklit të parë : Mësuesi për Arsimin Fillor, Mësuesi për Arsimin Parashkollor, dhe në programin e studimit të Ciklit të dytë : "Master Profesional": **MËSUESI PËR ARSIMIN E MESËM TË ULËT NË** : Histori, Gjeografi, me profil minor në Edukatë shoqërore, MËSUESI PËR AMU në Gjuhë - Letërsi Shqipe, me profil minor në gjuhë Italiane, MËSUESI PËR AMU në Gjuhë Angleze, me profil minor në gjuhë shqipe, Gjuhë - Letërsi dhe Qyteterim Grek, me profil minor në lëndët shoqërore, MËSUESI PËR AMU në Biologji - Kimi, me profil minor në edukim mjedisor e teknologjik, MËSUESI PËR AMU në Matematikë-Informatikë me profil minor në aftsim teknologjik, MËSUESI PËR AMU në Matematikë - Fizikë me profil minor në aftësim teknologjik. Në bazë të Udhëzimit Nr. 30 , datë 29.07.2008 i MASH - it "Për organizimin e studimeve të larta universitare për formimin profesional të mësuesve " dhe të Udhëzimit të MASH - it Nr. 4255, datë 22.10.2010 "Për rikonstruktimin e programeve të studimit të mësuesve " pika 4, **palët bien dakort:**

1. Praktikant profesional të studentëve të Universitetit të Gjirokastrës do të zhvillohen në mjediset e (shkollave) 9- vjeçare të qytetit me një shtrirje semestrale ,sipas planeve dhe programeve të degëve përkatëse.

2. Mësuesit mentorë që do të bashkëpunojnë për zhvillimin e praktikave profesionale vëzhguese, aktive duhet të jenë ndër më të përgatiturit nga ana shkencore dhe metodike mundësisht me gradën magistër.

3. Drejtoria Arsimore Rajonale me fillimin e vitit të ri akademik, miraton propozimet e dërguara nga Universiteti, me emrat e mësuesve mentorë që plotësojnë kriteret shkencore e metodike dhe i dërgon ato zyrtarisht pranë Universitetit të Gjirokastrës dhe Drejtorive të shkollave.



4. Drejtoritë e shkollave që janë caktuar për këtë qëllim, janë të detyruara të krijojnë kushtet e nevojshme për zhvillimin normal të praktikës profesionale, sipas programit të lëndëve përkatëse.

5. Kjo akt - marrëveshje ka vlerë për zhvillimin e praktikave afatshkurtra (një ditë në javë) që zhvillojnë studentët, sipas strukturës së vitit akademik që hartojnë departamentet.

6. Lista emërore e mësuesve që propozojmë të jenë mentorë , sipas shkollave është si më poshtë:

Nr	Departamenti	Shkolla ku do të zhvillohet praktika	Lënda	Emri, Mbiemri mësuesit
1	Histori-Gjeografi	9 - vjeçare "Koto Hoxhi"	Histori	Myrvete Kasa
			Gjeografi	Liliana Dervishi
2	Gjuhë-Lëtersi	9 - vjeçare "Koto Hoxhi"	Gjuhe	Sareta Haska,
			Letërsi	Frederika Boga
3	Gjuhë të Huaja	9 - vjeçare "Koto Hoxhi"	Anglisht	Manjola Ziu
4	Dep. i Edukimit dhe Metodologjisë së Mësimdhënies	9 - vjeçare "Koto Hoxhi"	Arsimi Fillor	Afërdita Gjokoli Adelina Barxo Etleva Korkuti Mirela Mamani Shqiponja Mamo
		9 - vjeçare "Koto Hoxhi"	Arsimi Parashkollor	Luiza Hysi
		Cicërimat		Faela Reçka (Kristo)
5	Gjuhë Greke	" Pandeli Sotiri "	Greqisht	Figalia Papa
6	Matematikë-Informatikë	9 - vjeçare "Koto Hoxhi"	Matematike	Violeta Çabej
			Informatikë	Zhuljeta Zhapa
7	Fizikë	9 - vjeçare "Koto Hoxhi"	Fizikë	Ana Malo
8	Biologji-Kimi	9 - vjeçare " Urani Rumbo "	Biologji	Merita Late
		9 - vjeçare "Koto Hoxhi"	Kimi	Vezir Mamo

7. Në zbatim të pikës 3 të kësaj akt-marreveshje , DAR u dërgon zyrtarisht Universitetit dhe Drejtorive të shkollave të miratuar apo me ndryshime të mundshme, listën me emrat e shënuar në pikën 6.

8. Kjo akt - marreveshje hyn në fuqi menjëherë.

Gjirokastër, më 20.10.2016





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
GJIROKASTËR

Nr 189 Prot.

Gjirokastrë, më 22. 02. 2017.

MARREVESHJE BASHKËPUNIMI

E lidhur sot, në datën 22. 02. 2017 ndërmjet palëve:

Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastrë përfaqësuar nga *Rektori, Prof.Dr Bektash MEMA*
dhe Dekani i Fakultetit të Shkencave të Natyrës, *Prof.Asoc.Dr Selfo ORUÇI*.

dhe

Drejtoria Rajonale e Shëndetësisë Gjirokastrë, përfaqësuar nga Drejtori, z. Shpetim Novi

Palët me vullnet të lirë bien dakort për sa më poshtë vijon:

Neni 1
Baza ligjore

Kjo kontratë mbështetet në Ligjin Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", në Ligjin Nr. 9106, datë 17.07.2003 "Për Shërbimin Spitalor në Republikën e Shqipërisë" si dhe në Ligjin Nr. 10107, datë 30.03. 2009 "Për Kujdesin Shëndetësor në Republikën e Shqipërisë".

Neni 2
Qëllimi i marrëveshjes

Qëllimi i kësaj marrëveshjeje është rregullimi i bashkëpunimit akademik-shkencor dhe profesional midis palëve nënshkruese.



Neni 3
Kohëzgjatja e marrveshjes

Kjo kontratë lidhet sot më datë 22. 02. 2017 dhe shtrin efektin e saj për një periudhë 3 (tre) vjecare.

Neni 4
Detyrimet e palëve

Njësia Bazë e Infermierisë është strukturë akademiko-shkencore e Fakultetit të Shkencave të Natyrës në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastrë. Studentët e kësaj njësie do të kryejnë praktikën profesionale dhe aktivitetin kërkimor-shkencor pranë Qendrës së Gruas dhe Ambulancave të Qendrës Shëndetësore Gjirokastrë.

Drejtoria e Shëndetit Publik Gjirokastrë është institucion publik i ofrimit të kujdesit shëndetësor, i cili vë në dispozicion të Njesisë Bazë të Infermierisë, ambjentet klinike, laboratorët e tyre dhe personelin e kualifikuar pa pagesë.

Neni 5

Njësia Bazë e Infermierisë, në Fakultetin e Shkencave të Natyrës të Universitetit "Eqrem Çabej", mundëson realizimin e praktikave profesionale të studentëve të saj pranë ambjenteve të Qendrës së Gruas dhe Ambulancave të Qendrës Shëndetësore Gjirokastrë.

Neni 6

Njësia Bazë e Infermierisë shërben si burim i njohuriëve më të fundit në fushën e diagnostikimit dhe terapisë të sëmundjeve torakale, abdominale, vaskulare, endoskopisë digjестive, kirurgjikale, obstetrikale, pediatrike nëpërmjet personelit akademik dhe shkencor të saj në bashkëpunim me partnerë europianë dhe mjekët e Drejtorisë së Shëndetit Publik Gjirokastrë.

Neni 7

Njësia Bazë e Infermierisë në bashkëpunim me Drejtorinë e Shëndetit Publik Gjirokastrë ofron për komunitetin diagnostikimin dhe mjekimin medikamentoz dhe promocionin shëndetësor.

Neni 8

Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, Fakulteti i Shkencave të Natyrës, Njësia Bazë e Infermierisë dhe Drejtoria e Shëndetit Publik Gjirokastrë krijojnë mundësinë për punë kërkimore shkencore të pavarur të personelit dhe studentëve duke vënë në dispozicion kapacitete me teknologji të avancuara.



Neni 9

Nësia Bazë e Infermierisë e Fakultetit të Shkencave të Natyrës në bashkëpunim me Klinikat, Universitetet e huaja dhe Drejtorinë e Shëndetit Publik Gjirokastrë, do të mundësojë bashkëpunimin mësimor, kërkimor-shkencor dhe realizimin e Konferencave Shkencore Kombëtare dhe Ndërkombëtare me pjesëmarrjen e personelit shëndetësor në fusha të ndryshme të mjekësisë.

Neni 10

Duke shfrytëzuar bashkëpunimet që ka Universiteti "Eqrem Çabej" me homologët e vet europianë, Njësia Bazë e Infermierisë, si pjesë e këtij Universiteti, realizon kualifikime afatshkurtra dhe afatgjata të pedagogëve, mjekëve, infermierëve, studentëve si dhe praktikat profesionale.

Neni 11

Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, Drejtoria e Shëndetit Publik Gjirokastrë, Fakulteti i Shkencave të Natyrës dhe Njësia Bazë e Infermierisë angazhohen për rritjen e shkallës së profesionalizmit nëpërmjet ngritjes së Sistemit të Edukimit Mjekësor të Vazhdueshëm dhe testimit për të gjitha kategoritë e personelit në mjekësi.

Neni 12


Marrëdhëniet financiare të personelit akademik mjek, infermier dhe ndihmës mësimor të Njesisë Bazë të Infermierisë rregullohen me aktet ligjore në fuqi

Prof.dr. Bektash MEMA



Rektor

Shpëtim NOVI



Drejtor

Prof. Asoc. Dr. Selfo ORUÇI



Dekan





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
GJIROKASTËR

Nr 235 Prot.

Gjirokastrë, më 06.03.2017

MARREVESHJE BASHKËPUNIMI

E lidhur sot, në datën 06.03.2017 ndërmjet palëve:

Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastrë përfaqësuar nga ***Rektori, Prof.Dr Bektash MEMA***
dhe Dekani i Fakultetit të Shkencave të Natyrës, ***Prof.Asoc.Dr Selfo ORUÇI***.

dhe

Drejtoria e Spitalit Rajonal "Omer Nishani" Gjirokastrë, përfaqësuar nga Drejtori, z.
Krenar Kulla

Palët me vullnet të lirë bien dakort për sa më poshtë vijon:

Neni 1
Baza ligjore

Kjo kontratë mbështetet në Ligjin Nr. 80/2015 "*Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*", në Ligjin Nr. 9106, datë 17.07.2003 "*Për Shërbimin Spitalor në Republikën e Shqipërisë*" si dhe në Ligjin Nr. 10107, datë 30.03.2009 "*Për Kujdesin Shëndetësor në Republikën e Shqipërisë*".

Qëllimi i marrëveshjes

Neni 2

Rregullimi i bashkëpunimit akademiko-shkencor dhe profesional midis palëve nënshkruese.



Neni 3

Kohëzgjatja e marrëveshjes

Kjo kontratë lidhet sot më datë 06.03.2017 dhe shtrin efektin e saj për një periudhë 3 (tre) vjetecare.

Detyrimet e palëve

Neni 4

Njësia Bazë e Infermierisë është strukturë akademiko-shkencore e Fakultetit të Shkencave të Natyrës në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastrë. Studentët e kësaj njësie do të kryejnë praktikën profesionale dhe aktivitetin kërkimor-shkencor në Spitalin Rajonal Gjirokastrë.

Spitali Rajonal Gjirokastrë është institucion publik i ofrimit të kujdesit shëndetësor të specializuar, i cili vë në dispozicion të Njesisë Bazë të Infermierisë, ambjentet klinike, laboratorët në të gjitha specialitetet strukturale, diagnostikuese, kurative në të gjitha repartet, si Shërbimin e Patologjisë, Shërbimin e Kirurgjisë, Shërbimin e Obstetrikë-Gjinekologjisë, Shërbimin e Pediatriisë, Shërbimin e Urgjencës, Shërbimin Diagnostikues Imazherik, Shërbimin e Ambulancës Qëndrore, Shërbimin e Sëmundjeve Infektive pa pagese.

Neni 5

Njësia Bazë e Infermierisë në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, Universiteti "Eqrem Çabej" mundëson realizimin e praktikave profesionale të studentëve të saj në specialitete të ndryshme, në bashkëpunim me strukturat e kujdesit spitalor.

Neni 6

Njësia Bazë e Infermierisë shërben si burim i njohurive më të fundit në fushën e diagnostikimit dhe terapisë të sëmundjeve torakale, abdominale, vaskulare, endoskopisë digjестive, kirurgjikale, obstetrikale, pediatrike nëpërmjet personelit akademik dhe shkencor të saj në bashkëpunim me partnerë europianë dhe specialistët e Spitalit Rajonal Gjirokastrë

Neni 7

Njësia Bazë e Infermierisë në bashkëpunim me Spitalin Rajonal Gjirokastrë ofron për komunitetin diagnostikimin dhe terapinë intervenuese në fushën e sëmundjeve torako-abdominale, kirurgjikale dhe vaskulare.

Neni 8

Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, Fakulteti i Shkencave të Natyrës, Njësia Bazë e Infermierisë dhe Spitali Rajonal Gjirokastrë krijojnë mundësinë për punë kërkimore shkencore të pavarur të personelit dhe studentëve duke vënë në dispozicion kapacitete me teknologji të avancuara.



Neni 9

Nësia Bazë e Infermierisë e Fakultetit të Shkencave të Natyrës në bashkëpunim me Klinikat, Universitetet e huaja dhe Siatli Rajonal Gjirokastrë, do të mundësojë bashkëpunimin mësimor, kërkimor-shkencor dhe realizimin e Konferencave Shkencore Kombëtare dhe Ndërkombëtare me pjesëmarrjen e specialistëve në fusha të ndryshme të mjekësisë.

Neni 10

Duke shfrytëzuar bashkëpunimet që ka Universiteti "Eqrem Çabej" me homologët e vet europianë, Njësia Bazë e Infermierisë, si pjesë e këtij Universiteti, realizon kualifikime afatshkurtra dhe afatgjata të pedagogëve, mjekëve, infermierëve, studentëve si dhe praktikant profesionalë.

Neni 11

Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, Spitali Rajonal Gjirokastrë, Fakulteti i Shkencave të Natyrës dhe Njësia Bazë e Infermierisë angazhohen për rritjen e shkallës së profesionalizmit nëpërmjet ngritjes së Sistemit të Edukimit Mjekësor të Vazhdueshëm dhe testimit për të gjitha kategoritë e personelit në mjekësi.

Neni 12

Marrëdhëniet financiare të personelit akademik mjek, infermier dhe ndihmës mësimor të Njesisë Bazë të Infermierisë rregullohen me aktet ligjore në fuqi

Kjo marrëveshje është e detyrueshme nga palët nënshkruese për realizimin e saj.

Prof.Dr. Bektash MEMA



Rektor

Krenar KULLA

The image shows a handwritten signature of Krenar KULLA over a circular official stamp. The stamp contains the text "REPUBLIKA E SHQIPERISE", "UNIVERSITETI 'EQREM ÇABEJ'", "FAKULTETI I SHKENCËVE TË NATYRËS", and "GJIROKASTËR". In the center of the stamp is the coat of arms of Albania.

Drejtor

Prof. Asoc. Dr. Selfo ORUÇI



Dekan

